



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:046645

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05826175

2024:046646

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të pandehurës J.D me vendbanim nga fshati B... Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës me kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Ferizaj e evidentuar si: PP.II.nr.21/24 e datës 09 Shkurt 2024, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor me datë 14 Qershor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj së bashku me aktakuzë e evidentuar si: PP.II.nr.21/24 e datës 09 Shkurt 2024, për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe nga kjo gjykatë, shqiptohet :

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurës:

J.D, e lindur me datë ..., në K..., nga i ati B... e ëma L... e gjinisë C..., me vendbanim në fshatin B..., Komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 01.11.2023, në Ferizaj, e pandehura J.D duke vepruar me dashje me qëllim të frikësimit dhe shkakimit të ankthit, seriozisht e kanos të dëmtuarën K.Z, në atë mënyrë që pasi e dëmtuara e kishte thirrur në telefon bashkëshortin e të pandehurës, me ç’rast e pandehura përmes telefonit mobil duke e përdorur rrjetin social “ viber ” i drejtohet të dëmtuarës me fjalët kërcënuese “*me ba me thirrë K. ti ma, kam me dal zhag kom me të ngreh neper Ferizaj hiç ma larg se nesër ka me të ngreh zhag ty*”, me ç’rast me këto fjalë tek e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës, ankthit dhe pasigurisë për jetën e saj.

- **me te cilin veprim kreu veprën penale kanosja nga neni 181 par.1 te KPRK-ës**

Andaj gjykata në bazë të nenit 2, 4, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPPK-së, të pandehurin e,

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 Euro (katërqind euro), të cilin gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 € /njëzetë euro/ të gjobës së pa paguar, do ti llogaritet me 1/një/ ditë burgimi.

E dëmtuara K.Z me adresë në rrugën “...” ..., .., nr.36 në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë euro/ si dhe në bazë të nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë euro/, brenda afatit prej tridhjetë /30/ ditëve pas aktgjykimi të merr formën e prerë, ose do të bëhet përmbarimi i detyruar sipas detyrës zyrtare.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese ka vepruar në çështjen penale kundër të pandehurës J.D me vendbanim në fshatin B..., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës me kërkesë për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Ferizaj e evidentuar si: PP.II.nr.21/24 e datës 09 Shkurt 2024, me të cilën ka kërkuar dhënien e urdhërit ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe atë bazuar në nenin 495 par 1. të KPPK-ës.

Gjithashtu pas vlerësimit të provave materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit: 2023-CF-2494, raporti i oficerit i datës 06.11.2023, raporti i policit hetues i dt. 16.12.2023, raporti njoftues lidhur me veprimet hetimore i policit hetues, kartela e viktimës me nr. të rastit:2023-CF-2494, deklarata e të dëmtuarës: K.Z e datës 06.11.2023 dhe dt.08.11.2023, deklarata e dëshmitarit: S.V e dt. 29.11.2023, mesazhet (sms-të) me nr. të rastit 2023- CF-2494 dhe, si dhe shkresat e tjera te cilat gjenden në lëndë.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi që nga të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të procedurës nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm.

Vendimi mbi shpenzimet paushall është marr në kuptim të dispozitës së nenit 449 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Penal,

2024:046646 i datës 14 Qershor 2024

Bashkëpunëtori profesional

Shkelzen Polloviqi

Gjyqtarja,

Mimoza SHABANI

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të tij. Kundërshtimi i dorëzohet kësaj Gjykate.